



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

*Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike,
Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm.*

Nr.606/6 Prot.

Tiranë, më 30.09.2016

V E N D I M

Nr.131, Datë 30.09. 2016

PËR

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË
DREJTORINË E PROKURIMEVE TË PËRQËNDRUARA NË MINISTRINË
E BRENDSHME ME OBJEKT: “AUDITIMI I PËRPUTHSHMËRISË DHE
RREGULLSHMËRISË FINANCIARE I PROKURIMEVE TË
PËRQËNDRUARA PËR VITIN 2015”.**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit dhe Zbatimit të Standardeve, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 10 dhe 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit me objekt “Zbatimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare të prokurimeve të përqendruara për vitin 2015”.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. PROPOZIME PËR PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI:

1. Gjatë viteve buxhetore, disa autoritete kontraktore për nevoja të tyre, prokurojnë të njëjtat mallra ose shërbime. Për këtë arsye, në neni 11, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe në nenin 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, janë përcaktuar rregullat për kryerjen e prokurimit të përqendruar. Sipas kësaj baze ligjore, prokurimi i përqendruar mund të përdoret kur blerja e përqendruar mundëson përfitime ekonomike për shkak të rritjes së sasisë së mallrave, punëve ose shërbimeve homogjene dhe që ofrohen në treg me kushte të ngjashme, si dhe kur autoriteti kontraktor (AK), që luan rolin e organit qendror blerës, ka njohuritë e mjaftueshme për artikujt që do të prokurohen. Në zbatim të kësaj baze ligjore, ka dalë VKM nr. 28, datë 14.01.2015, “Për ngarkimin e Ministrisë së Brendshme, për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë”. Kjo VKM, ka ngarkuar MB si Organ Qendror Blerës (OQB), për kryerjen e procedurave të prokurimit të përqendruar. Për realizimin e kësaj detyre në strukturën e MPB është ngritur dhe funksionon Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara (DPP). Nisur nga eksperiencia që ka kjo Drejtori në fund të vitit 2014 dhe në janar të vitit 2015 për disa nga mallrave që prokuron, ka bërë testimin e tregut, ka hartuar tabelat përmbledhëse me specifikimet teknike të unifikuara si dhe çmimet e referencës. Me shkresa zyrtare u ka kërkuar Kryeministrisë, ministrive, dhe institucioneve në varësi, dërgimin e të dhënave me qëllim që kjo drejtori të organizojë punën për zhvillimin e procedurave të prokurimit të përqendruar si dhe u ka dërguar tabelat përmbledhëse me specifikimet teknike të unifikuara si dhe çmimet e referencës për disa nga mallrat që do të blihen me qëllim që autoritetet kontraktore të unifikojnë specifikimet teknike dhe të përcaktojnë fondin limit që do të prokurohet. Sipas të dhënave që ka DPP për vitin 2015 janë paraqitur rreth 670 kërkesa nga autoritete kontraktore, të cilat, pasi janë shqyrtuar ka nisur puna për përgatitjen dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit të përqendruar.

Konstatohet se një pjesë e konsiderueshme e autoriteteve kontraktore nuk e kanë respektuar afatin ligjor 31.01.2015, të përcaktuar në VKM nr 28, datë 14.01.2015 për dërgimin e të dhënave teknike e sasiore dhe fondin përkatës për çdo prokurim, në OQB, duke sjellë vështirësi e vonesa të panevojshme në zhvillimin e procedurave të prokurimit. Në asnjë nga dispozitat ligjore që përcaktojnë kryerjen e prokurimit të përqendruar, nuk ka sanksione për autoritete kontraktore që pa arsye të justifikuara, vonojnë paraqitjen e të dhënave pranë OQB, e për rrjedhojë zgjasin afatet e zhvillimit të tenderëve dhe shkaktojnë vështirësi në plotësimin e nevojave për mallra e shërbime për administratën publike (*trajtuar më hollësisht në faqen 11-13, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Ministria e Brendshme, në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik ti propozojnë Këshillit të Ministrave që në VKM nr 28, datë 14.01.2015, të bëhet një shtesë për të përcaktuar “Kundërvajtjet administrative” ndaj Autoriteteve Kontraktore që shkelin afatet e paraqitjes së treguesve të nevojshëm për zhvillimin e procedurave të përqendruara.

Menjëherë

2. Gjatë vitit 2015, DPP ka zhvilluar 46 procedura prokurimi të ndara në rreth 105 lote, me një fond limit të llogaritur si shumë të fondeve buxhetore në vlerën rreth 5,300 milion lekë. Nga këto janë anuluar 27 lote të ndryshme me vlerë rreth 280 milion lekë, dhe janë realizuar 46 procedura prokurimi të ndara në rreth 78 lote me një fond limit të llogaritur në vlerën rreth 5,020 milion lekë. Në përfundim të procedurave të prokurimit të zhvilluara, janë shpallur fitues operatorë ekonomik me të cilët janë lidhur kontrata me vlerë të përgjithshme rreth 4,620 milion lekë. *(Nga realizimi i procedurave të prokurimit të përqendruar, është realizuar një kursim në vlerën rreth 400 milion lekë ose 8 % e fondeve buxhetore të planifikuara për këto blerje dhe shërbime)*. Hartimi i specifikimet teknike dhe llogaritja e vlerës së kontratave të këtyre procedurave, sipas ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, është përgjegjësi e AK të cilat i dërgojnë ato në OQB së bashku me kërkesën për prokurim. Ndërsa OQB në zbatim të VKM nr. 28, datë 14.01.2015 ka përgjegjësinë të prokurojë fondin limit, të llogaritur si shumë e fondeve buxhetore, të miratuar për çdo institucion. Për këtë në zbatim të kësaj VKM, siç u tha edhe më sipër, OQB ka unifikuar specifikimet teknike, të ardhura nga çdo AK, si dhe ka bashkërenduar punën për testimin e tregut, dhe të dhënave sasiore për mallrat dhe shërbimet që do të prokurohen para publikimit të çdo procedure. Kështu, pothuajse për të gjitha procedurat e mësipërme, titullari i OQB me urdhra të brendshëm ka ngritur grupin për testimin e tregut. Në përfundim ka llogaritur vlerën e përgjithshme të kontratës duke u bazuar në çmimet e tregut të llogaritur si mesatare e çmimeve të 3,4 apo 5 ofertave të marra në treg. Fondi limit për çdo procedurë është llogaritur pothuajse në vlerën e njëjtë, po aq sa është edhe shumatorja e fondeve limite të ardhura nga AK. Pra, mesatarja e çmimeve të ofertave ka dalë e barabartë me mesataren e çmimeve të dërguara nga AK, ndërkohë që nuk dihen se AK, kujt çmimeve u janë referuar për llogaritjen e fondit limit: të tregut, të kontratave të mëparshme, të ISTAT, etj, sepse bashkëlidhur kërkesave për kryerjen e prokurimeve nuk kanë dërguar informacion në lidhje me argumentimin e fondit limit. Ky veprim tregon për fiktivitet dhe formalitet të punës së OQB e cila edhe pse nuk e ka detyrë funksionale llogaritjen e fondit limit nuk duhet të llogariste atë si mesataren e ofertave të marra në treg, por duhej ta llogariste në bazë të ofertës më të ulët të marrë në treg dhe kështu fondi limit do të ishte më i ulët. Duke marrë për bazë mesataren e ofertave dhe jo ofertën më të ulët, fondi limit rritet në mënyrë artificiale. Ky veprim krijon hapësira të cilat shfrytëzohen nga disa operatorë të ndryshëm të cilëve u janë marrë oferta për llogaritjen e fondit limit dhe i kanë paraqitur më të ulët se mesatarja. Nisur nga kjo, këta operatore mund të marrin pjesë në procedurat e prokurimit dhe mund të paraqesin ofertat e tyre me të larta se ofertat e paraqitur për testimin e tregut, dhe për pasojë do të kemi rritje të vlerës së kontratës më të lartë se sa vlera aktuale e tregut. Fiktiviteti dhe formaliteti i punës së OQB në lidhje me llogaritjen e fondit limit tregohet edhe në një rastë ku për blerje “Blerje Automjetesh për Komandën e Forcës Tokësore në fond limit prej 27,799,200 lekë, është përfshirë gabimisht edhe vlera e TVSH në shumën 4,633,200 lekë. OQB nuk ka bërë rishikimin e këtij fondi dhe ka shpallur për prokurim të gjithë vlerën përfshi edhe TVSH. *(Në këtë rast nuk kemi dëm ekonomik sepse fituesi ka paraqitur ofertën rreth 27 % më të ulët se fondi limit i shpallur)*. Duke marrë shkas nga këto veprime, gjykojmë se, detyrimi ligjor për rishikimi i fondit limit nga OQB për blerjet dhe shërbimet e përqendruara do të rriste

ndjeshëm përfitimet ekonomike për fondet publike që janë vënë në dispozicion nga buxheti e shtetit për AK. Për këtë është e nevojshme rishikimi i dispozitave ligjore që rregullojnë kryerjen e prokurimeve të përqendruar pasi, në VKM nr. 28, datë 14.01.2015, është përcaktuar se “*MB të prokurojë fondin limit, të llogaritur si shumë e fondeve buxhetore, të miratuar për çdo institucion, për secilin nga mallrat dhe shërbimet e përmendura në këtë vendim*”, çka do të thotë se OQB, bën bashkimin mekanik të fondeve buxhetore që ka miratuar çdo institucion për secilin mall apo shërbim në fillim të vitit dhe nuk llogarit fondin limit me çmimet aktuale të tregut që janë në kohën e shpalljes së njoftimit të kontratës. Nisur nga kjo gjykojmë se pika 2, e VKM nr. 28, datë 14.01.2015, duhet ndryshuar, duke i dhënë OQB të drejtën e rishikimit të fondeve buxhetore dhe përcaktimin e fondit limit, në zbatim të nenit 59, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik” (*trajtuar më hollësisht në faqen 11-14, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë;

-Ministria e Brendshme, në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik ti propozojnë Këshillit të Ministrave që pika 2, e VKM nr. 28, datë 14.01.2015 të ndryshoj dhe të formulohet në zbatim të nenit 59, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014.

Menjëherë

3. Në zbatim të VKM nr. 28, datë 14.01.2015, OQB pas mbledhjes së të dhënave nga AK, nis procedurat e prokurimit sipas LPP dhe DST dhe është plotësisht përgjegjës për kryerjen e të gjithë procedurës së prokurimit, *duke filluar nga njoftimi i kontratës deri në njoftimin e fituesit*. Nga auditimi për zbatimin e procedurave të prokurimit të zhvilluara u konstatuam disa boshllëqe apo hapësira ligjore *në përmbajtje të akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë prokurimin publik, për shkak të të cilave gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit janë shfaqur:*

-*Raste të pengimit dhe kufizimit të konkurrencës, të cilat janë bërë shkak për anullimin e procedurave. Për pasojë, disa AK të cilat kanë pasur nevojë të menjëhershme për mallra dhe shërbime kane zhvilluar procedura me negociim pa shpallje paraprake të kontratës. Nga ky veprim nuk është siguruar eficienta dhe efikasitetit i procedurave të prokurimit, në kontraditë me qëllimin e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” (neni 2) që bën fjalë për “rritjen e eficientës dhe efikasitetit të procedurave të prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore”.*

-*Raste të përdorimit të fondeve buxhetore pa efektivitet dhe pa ekonomikitet, si pasojë e të cilave buxheti i shtetit ka pasur impakt negativ me rritje të kostos së disa blerjeve dhe shërbimeve në vlerën totale **41,179,482 lekë**, në kontraditë kjo me qëllimin e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 (neni 2) që bën fjalë për “sigurimin e mirëpërdorimit të fondeve publike”.*

Problemet e mësipërme janë konstatuar në këto procedura:

3.1. Për prokurimin e “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (katering)” gjatë vitit 2015 janë zhvilluar dy procedura, njëra është zhvilluar në muajin qershor e ndarë në 17 lote me fondi limit në total 394,541,701 lekë dhe tjetra është zhvilluar në muajin dhjetor e ndarë në 5 lote me fondi limit në total 97,829,176 lekë. Nga 17 procedura të zhvilluara në muajin qershor, 10 procedura janë anuluar për shkak se nuk morri pjesë asnjë operatore, dhe për 7 të tjera u shpallën fituesit dhe nga këto në 5 procedura ka marrë pjesë vetëm një operatore dhe në 2 procedurat e tjera kanë marrë pjesë 2

operatorë. Kështu, mbas njoftimit të 7 fituesve, për 2 lote të tjera nuk u lidhën kontratat dhe këto procedurat janë anuluar, pra nga 17 procedura të zhvilluara me fond limit 394,541,701 lekë, 12 prej tyre me fond limit 195,849,611 lekë janë anuluar për shkak të mungesës së konkurrencës dhe vetëm 5 procedurat me fond limit 186,578,315 lekë janë shpallur fitues të cilat kanë lidhur kontratat e zbatimit. Nga 5 procedura e zhvilluara në muajin dhjetor me fond limit 97,829,176 lekë 4 prej tyre me fond limit 75,199,176 lekë janë anuluar për mungesë konkurrence dhe vetëm një procedurë me fond limit 22,630,000 lekë është realizuar dhe është lidhur kontrata. Edhe në këtë procedurë ka marrë pjesë vetëm 1 operatarë.

Si konkluzion: për të gjithë vitin 2015 shërbimi i kateringut është prokuruar në dy raste për 22 lote me vlerë totale 492,370,877 lekë nga të cilat 16 lote në vlerën 271,048,787 lekë janë anuluar, dhe janë realizuar vetëm 6 lote me fond limit 221,000,000 për të cilat janë lidhur 6 kontrata me vlerë 209,208,315,315 lekë. Për këtë arsye AK, të cilat kanë pasur domosdoshmëri nevojë për këtë shërbim, pas anulimit të tenderëve kanë lidhur kontrata të drejtpërdrejta me procedurë me negociim. Përdorimi i kësaj procedure nuk mundëson konkurrencë, mirëpërdorim dhe kursim të fondeve, për më tepër në zbatim të nenit 33 ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 dhe nenit 36 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, përdorimi i kësaj procedure nuk justifikohet me mungesën e konkurrencës, sepse AK e përdorë këtë procedurë kur në dy procedura të njëpasnjëshme nuk është dorëzuar asnjë ofertë për pjesëmarrje. Në çdo rast, mosdorëzimi i asnjë oferte nuk duhet të vijë si shkak i gabimeve të bëra në dokumentet e tenderit dhe/ose për shkak të ndonjë veprimi të AK. Po kështu edhe neni 73 i kësaj VKM përcakton që të vazhdojë procesi i përzgjedhjes së fituesit në një procedurë prokurimi, duhet të pranohet të paktën 1 ofertë e vlefshme. Në të kundërt, AK anulon procedurën dhe fillon një procedurë të re prokurimi. AK, përpara se të fillojë një procedurë të re, analizon shkaqet që shkaktuan dështimin e procedurës dhe i korrigjon ato në mënyrë që të bëjë të mundur rritjen e konkurrencës. Pra sipas VKM nr. 28, datë 14.01.2015, OQB është përgjegjëse për kryerjen e procedurës së prokurimit duke filluar nga njoftimi i kontratës deri në njoftimin e fituesit, ndërsa AK janë përgjegjëse për hartimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit. Mirëpo DT hartohen mbi bazën e specifikimeve teknike, të sasisë dhe vlerës së kontratës. Nisur nga këto, gjykojmë se mos përmbushja e qëllimit të rregullave të prokurimit publik në lidhje me mos arritjen e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit nga OQB, ka ardhur nga paqartësitë apo nga vakumi i përmbajtjes së VKM nr. 28, datë 14.01.2015 (*trajtuar më hollësisht në faqen 15-22, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër (3.1) rekomandojmë;

-Ministra e Brendshme, në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik ti propozojnë Këshillit të Ministrave që në VKM nr. 28, datë 14.01.2015 të bëjë një shtesë për të përcaktuar mënyrën dhe procedurën e prokurimit që do të ndiqet nga Autoritetet Kontraktore apo DPP në rast të dështimit të procedurës së prokurimit të përqendruar.

Menjëherë

3.2. Në prokurimin për “Blerje Materiale të buta dhe veshmbathje (Loti I)” me fond limit 27,985,529 lekë, kanë marrë pjesë 4 operatorë. Është kualifikuar dhe është shpallur fitues operatori “E...” me vlerë oferte 27,425,835 lekë. Janë s`kualifikuar 3

operatorët e tjerët të cilët i kanë pasur oferta më të ultë se operatori fitues. Një operator është s`kualifikuar me Vendim të KPP, një është s`kualifikuar sepse nuk plotëson kërkesat e vendosura në DT, ndërsa operatori “W..” i cili kishte ofertën në vlerën 20,300,000 lekë ose më të ulët se fituesi me diferencë në vlerën në vlerën 7,125,835 lekë, mbas 12 ditësh nga data e hapjes së ofertave është tërhequr në mënyrë të njëanshme nga procedura e prokurimit. Për këtë tërheqje ky operator është justifikuar se, oferta e paraqitur nuk është koherente me çmimet e tregut. Nga tërheqja në mënyrë të njëanshme e këtij operatori, **8,551,002 lekë** fonde buxhetore nuk i janë kursyer buxhetit të shtetit, por janë përdorur pa efektivitet dhe pa economicitet (*trajtuar më hollësisht në faqen 22-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.3 Në prokurimin “Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyrash” me fond limit 92,076,362 lekë, kanë marrë pjesë 4 operatorë. Janë kualifikuar 2 operatorë. Fitues ka dalë operatori “E...” me vlerë oferte 90,040,150 lekë. Janë s`kualifikuar 2 operatorët e tjerë të cilët kanë paraqitur oferta më të ultë në tender se operatori fitues, respektivisht, operatori “S...” me ofertë në vlerën 69,000,000 lekë ose më të ulët për 21,040,150 lekë dhe operatori “M. L” me ofertë në vlerën 63,535,350 lekë ose më të ulët për 26,504,800 lekë. Operatori “S...” është s`kualifikuar në përputhje me rregullat e prokurimit publik sepse nuk plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, ndërsa operatori “M. L” është s`kualifikuar sepse oferta e tij ka dalë anomalish e ulët. Në këto kushtet e ofertës anomalish të ulët, KVO me shkresë zyrtare dhe elektronike i ka kërkuar këtij operatori informacion të detajuar në lidhje me analizën e kostos. Mirëpo, ky operator nuk ka paraqitur argumentimin mbi ofertën anomalish të ulët, as në mënyrë shkresore dhe as elektronike. KVO në zbatim të neni 56 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 e ka s`kualifikuar nga procedura e prokurimit. Nga mos paraqitja e argumentimit të çmimit të ofertës, **31,805,760 lekë**, fonde buxhetore me TVSH, nuk i janë kursyer buxhetit të shtetit, por janë përdorur pa efektivitet dhe pa economicitet (*trajtuar më hollësisht në faqen 24-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.4. Në prokurimin “Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyrash” me fond limit 5,135,242 lekë. Në tender kanë marrë pjesë 7 operatorë. Janë kualifikuar 3 operatorë. Fitues ka dalë operatori “E...” me vlerë oferte 4,000,600 lekë. Janë s`kualifikuar 4 operatorët e tjerë, 3 nga të cilët kanë ofertat më të larta se fituesi dhe janë s`kualifikuar në përputhje me rregullat e prokurimit publik sepse nuk plotësonin kërkesat e vendosura në DT. Ndërsa operatori “M. L” ka paraqitur oferta në vlerën 3,315,000 lekë ose më të ultë se operatori fitues, për vlerën 685,600 lekë me TVSH, dhe është s`kualifikuar sepse oferta ka dalë anomalish e ulët. Edhe në këtë rast, KVO me shkresë zyrtare dhe elektronike i ka kërkuar informacion të detajuar në lidhje me analizën e kostos. Mirëpo, ky operator nuk ka paraqitur argumentimin mbi ofertën anomalish të ulët, dhe në zbatim të rregullave të prokurimit është s`kualifikuar nga procedura e prokurimit. Nga mos paraqitja e argumentimit të çmimit të ofertës, **822,720 lekë** fonde buxhetore me TVSH, nuk i janë kursyer buxhetit të shtetit, por janë të përdorur pa efektivitet dhe pa economicitet (*trajtuar më hollësisht në faqen 27-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Veprimet e mësipërme kanë ndodhur sepse, baza ligjore që rregullon prokurimin publik nuk parashikon sanksione apo penalitete për operatorët që tërhiqen në mënyrë të njëanshme mbas hapjes dhe leximit të ofertave dhe për operatorët që nuk paraqesin sqarime për të argumentuar ofertat anomalish të ultë. Mos përcaktimi i sanksioneve dhe penaliteteve për operatorët që tërhiqen nga procedura dhe për mos argumentim të çmimit të ofertës, shtrembëron dhe denatyron qëllimin e rregullave të prokurimit publik, sepse lejon hapësira që disa operatorë të ndërtojnë çmimet e ofertave të tyre shumë të ultë në mënyrë të papërgjegjshme dhe pas leximit të ofertave të tjera pjesëmarrës në procedurë, negociojnë me ofertuesit që kanë ofertat më të lartë dhe tërhiqen qetësisht nga procedura pa u ndëshkuar me gjoba apo përjashtime nga prokurimet publike.

Për sa më sipër (pika 3.2,3.3 dhe 3.4), rekomandojmë:

-Ministria e Brendshme, në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik ti propozojnë Këshillit të Ministrave që në ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për rregullat e Prokurimit Publik” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, të përcaktojë sanksione ndaj operatorëve ekonomik që, tërhiqen në mënyrë të njëanshme nga procedura e prokurimit, mbas hapjes dhe leximit të ofertave.

Menjëherë

4. Në përgjithësi i gjithë dokumentacioni i prokurimit është hedhur dhe ka kaluar në platformën elektronike të faqes së APP-së në përputhje me rregullave të prokurimit publik. Por u konstatua se, dy veprimet e fundit, njoftimet për nënshkrimin e kontratave dhe arkivimi i tyre, është bërë me shumë vonesë në platformën elektronike. Kjo ka ndodhur për arsye se, AK kanë njoftuar me shumë vonesë OQB për nënshkrimin e kontratave me operatorët të shpallur fitues (*trajtuar më hollësisht në faqen 59-98, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë;

-Ministria e Brendshme, në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik, ti propozojnë Këshillit të Ministrave që në VKM nr. 28, datë 14.01.2015, të bëhet një shtesë për të përcaktuar detyrimin që kanë Autoritetet Kontraktore për të njoftuar brenda tre ditëve OQB, për lidhjen e kontratave me operatorët ekonomik të shpallur fitues.

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE

1. OQB, zbaton dispozitat e LPP dhe është plotësisht përgjegjës, për kryerjen e të gjithë procedurës së prokurimit, që nga njoftimi i kontratës deri te publikimi i njoftimit të fituesit. Mirëpo, aktualisht kjo drejtori nuk i ka kapacitetet dhe njohuritë e mjaftueshme për artikujt që prokuron pasi, në strukturën ekzistuese, nuk ka asnjë specialist të fushës për shqyrtimin dhe unifikimin e specifikimeve teknike dhe testimin e tregut për: blerjen e automjeteve dhe të pjesëve të ndërrimit, për blerjen e pajisjeve elektronike dhe të telekomunikacionit, për blerjen e mallrave të ndryshme, për shërbimet e gatimit, të lavanterisë dhe hotelerisë etj, profesione këto që mbulohen nga ing. Mekanik transporti, ing. Elektronik(IT) dhe Merceolog industrial apo ushqimor.

Nisur nga kjo, gjykojmë se për funksionimin në përputhje me LPP, kjo strukturë duhej të ishte organizuar me të tre komponentët kryesor funksional si: përcaktimi i titullarit të autoritetit kontraktor (neni 56), përcaktimi i strukturës që do të kryejë rolin e njësisë së prokurimit (neni 57) dhe të strukturës që do të kryejë rolin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (neni 58) *(trajtuar më hollësisht në faqen 99-101, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Ministria e Punëve të Brendshme, në bashkëpunim me APP të studiojnë strukturën ekzistuese të Drejtorisë së Prokurimeve të Përqendruara në raport me volumnin e punës që mbulon, me efektivitetin e fondeve publike që kursen, me kapacitetet njerëzore dhe përbërje profesionale që ka në raport me detyrat teknike e profesionale që mbulon dhe ti propozojnë Këshillit të Ministrave riorganizimin e saj në përputhje me kërkesat e neneve 56,57 e 58 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar si një njësi e pavarur nga ndonjë autoritet kontraktor për në varësi të drejtpërdrejtë të qeverisë.

Menjëherë

2. Në përbërje të strukturës së OQB nuk ka një punonjës të caktuar për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore mbi bazën e të cilave hartohen dhe paraqiten treguesit e raportimit. Gjykojmë se është tepër i nevojshëm krijimi i një regjistri apo i një data base ku të regjistrohen kërkesat e autoriteteve kontraktore me të gjitha të dhënat si numri e datë e kërkesës, sasia e mallrave, punëve apo shërbimeve të kërkuara, fondi limit i parashikuar prej tyre, fondi limit sipas urdhrorit të prokurimit të nxjerrë, vlera e shpallur fituese, emri i operatorit fitues, etje *(trajtuar më hollësisht në faqen 99-1-1, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara, me cilësinë e Organit Qendror Blerës, të marrë masat e nevojshme për krijimi i një regjistri apo të një data base ku të regjistrohen kërkesat e autoriteteve kontraktore me të gjitha të dhënat si, numri e datë e kërkesës, sasia e mallrave, punëve apo shërbimeve të kërkuara, fondi limit i parashikuar prej tyre, fondi limit sipas urdhrorit të prokurimit të nxjerrë, vlera e shpallur fituese, emri i operatorit fitues, etj *(trajtuar më hollësisht në faqen 99-101, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Menjëherë

3. Në disa procedura prokurimi si pasojë e vendosjes së disa kërkesave të veçanta në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik nuk kanë krijuar lehtësira dhe kushte për pjesëmarrje të biznesit të vogël dhe të mesëm. Përmendim disa: kërkesa për paraqitje të dokumentit për realizimet e xhirove mesatare, në fakt sipas rregullave të prokurimit duhen kërkuar vetëm xhirot vjetore; kërkesa për paraqitje dëshmimeve për realizime të furnizimeve të mëparshme të ngjashme të realizuara gjatë vitet konkrete 2012,2013 dhe 2014, ka lënë periudha të gjata mujore të vitit 2015 (kohës së zhvillimit të tenderit), pra operatorëve të krijuar rishtas (gjatë vitit 2015) u janë mohuar aktivitetet e zhvilluara gjatë muajve të këtij viti; janë kërkuar paraqitja e katalogëve për mallra të ndryshme dhe automjete dhe paraqitja e “Autorizimeve nga prodhuesit” ose nga “Distributorët”, ose të prodhimeve të bashkimit Europian, këto kërkesa kualifikuese nuk kanë mbështetje në asnjë nen të legjislacionit të prokurimit publik. Madje për

vendosjen e kërkesës kualifikuese të “Autorizimeve nga prodhuesit” ka pasur shpesh ankesa të ndryshme nga kandidatë konkurrues, ku një ankesë për tenderin “Blerje tonera” është shqyrtuar deri në Gjykatën e Lartë dhe kjo Gjykatë ka anuluar Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik, e cila kishte rrëzuar ankesën e operatorit për paraqitjen e “Autorizimit nga Prodhuesi” (*trajtuar më hollësisht në faqen 11-99, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë;

-Për çdo procedurë prokurimi, kriteret e veçanta, të hartohen duke mos vendosur kufizime dhe pengime të pa arsyeshme, me qëllim stimulimin e biznesit të vogël dhe të mesëm si dhe të çdo operatori ekonomik që kryhen veprimtari tregtare në të gjithë territorin e vendit.

Vazhdimisht

4. Në të gjitha procedurat për sistemet e teknologjisë së informacionit që ka zhvilluar OQB, konstatohet se hartimi i specifikimeve teknike dhe përlllogaritja e fondit limit për projektet e teknologjisë së informacionit, realizohet nga institucioni përfitues i projektit, ndërsa hartimi i kriterëve të veçanta që nevojiten për realizimin këtyre projekteve realizohet nga OQB. Për këto procedura OQB, nuk ka dokumentuar në mënyrë të argumentuar kërkesat për kapacitetin teknik që nevojiten për punime të caktuara në specifikime teknike, të cilat në disa raste rezultojnë të jene diskriminuese. Po kështu edhe kërkesat e kapacitetit teknik lidhur me autorizimin nga prodhuesi për shitje dhe suportet të pajisjeve fizike që nevojiten për realizimin e projekteve komplekse të teknologjisë së informacionit, nuk rezultojnë të jenë të unifikuara me të njëjtat kërkesa për pajisjet fizike në rastet e blerjeve të pajisjeve elektronike(*trajtuar më hollësisht në faqen 42-59, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë Rekomandojmë:

-Hartimi i kriterëve të veçanta kualifikuese dhe argumentimi i tyre, për projektet e teknologjisë së informacionit, të bëhet nga institucioni përfitues i projektit të cilat kanë hartuar edhe specifikimet teknike si dhe të unifikohen kërkesat për kapacitetin teknik lidhur me autorizimin nga prodhuesi për shitje dhe suportet e pajisjeve fizike për projekte të teknologjisë së informacionit me ato të “Blerjeve të pajisjeve elektronike”.

Vazhdimisht

5. Pranë OQB kanë ardhur në disa raste kërkesa për sqarime të DT, ankesa për vendosje të gabuara të kriterëve kualifikuese e specifikimeve teknike në DT si dhe ankesa për shqyrtime dhe vlerësime të gabuara nga KVO-të. OQB në të gjitha këto raste ka bërë shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të natyrave të ndryshme dhe ka kryer veprimet si në rrugë elektronike dhe shkresore. Por, vlen të theksohet se, nuk është vepruar konformë LPP, pasi nuk janë nxjerrë shkresat për ngritjen e komisioneve me personat konkretë për shqyrtimin e këtyre ankesave. Po kështu nuk në përfundim të shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave nuk janë nxjerrë vendimet përkatëse(*trajtuar më hollësisht në faqen 11-99, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë;

-OQB në përputhje me rregullat e prokurimit publik, për të gjitha rastet e kërkesave për sqarime të DT, ankesa për vendosje të gabuara të kriterëve kualifikuese dhe ankesa për vlerësime të gabuara të ofertave, të ngrejë grupe pune me emra konkret punonjësish për shqyrtimin e tyre dhe në përfundim të nxirren vendimet përkatëse.

Vazhdimisht

6. Të gjitha procedurat e prokurimeve të realizuar gjatë vitit 2015, nuk janë inventarizuar dhe dorëzuar në protokoll sipas rregullave të përcaktuara në ligjin “Mbi arkivat” (*trajtuar më hollësisht në faqen 11-99, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
Për sa më sipër rekomandojmë;

-OQB të marrë menjëherë masat për të arkivuar dosjet e tenderave të zhvilluara gjatë vitit 2015, sipa përcaktimeve të ligjit “Mbi arkivat”.

Vazhdimisht

C. MASA PËR PËRDORIMIN ME EFEKTIVITET, EFICENSË DHE EKONOMICITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Vajra lubrifikant, alkol frenash dhe pastrues motori (Loti III)”, me fond limit 39,055,625 lekë, kanë marrë pjesë 8 operatorë. Janë kualifikuar 4 operatorë. Fitues ka dalë operatori “T-O” me vlerë oferte 31,940,015 lekë. Janë s`kualifikuar 4 operatorët e tjerë, dy prej të cilëve kanë paraqitur oferta më të ultë se operatori fitues, respektivisht, operatori “B...” me diferencë më vlerën 32,390 lekë dhe operatori “A...” me diferencë më pak në vlerën 7,346,283 lekë, pa TVSH. Operatori “B...”, është s`kualifikuar nga KVO në zbatim të VKPP nr. 472/2015 datë 10.07.2015. Ndërsa operatori “A...” është s`kualifikuar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 53 të nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”. Sepse paqartësitë e konstatuara në dokumentet e ofertës teknike të tij, janë mangësi fare të pa përfillshme të cilat mund të konsideroheshin devijime të vogla pasi, nuk pengojnë ekzekutimin e kontratës. Konkretisht është s`kualifikuar sepse, certifikatën e cilësisë ISO 9001:2008 të prodhuesit nuk e ka dokument origjinal por e ka të printuar nga interneti dhe të noterizuar si dhe të dy katalogët e paraqitur nuk i ka katalog të prodhuesit të mallit. Për më tepër, KVO, nisur nga oferta më e ulët në tender në zbatim të pikës 1 të nenit 53, të sipërcituar, duhej që këtij ofertuesi ti kërkonte sqarime për këto paqartësi, me qëllim shqyrtimin dhe vlerësimin ofertës së tij sa më të drejtë në krahasimin me ofertat e tjera. Por, KVO i ka qëndruar strikt kërkesave të vendosura në DT dhe nuk i është referuar kësaj baze ligjore për ti konsideruar devijime të vogla këto mangësi apo paqartësi edhe pse ato nuk ndikonin dhe nuk pengonin ekzekutimin e kontratës në rast se ky operator shpallej fitues i tenderit. Këto shkelje kanë impakt negativ në buxhetin e shtetit pasi 8,815,540 lekë fonde buxhetore janë përdorur pa efektivitet dhe pa ekonomikitet. Kjo vlerë është llogaritur si difference e vlerës së ofertës së operatorit fitues me vlerën e ofertës më të ulët të operatorit të s`kualifikuar (*trajtuar më hollësisht në faqen 28-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë;

-Ministria e Brendshme (Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara) të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësinë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike në vlerën 8,815,540 lekë.

Menjëherë.

2. Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale pastrimi” me fond limit 48,269,522 lekë, OQB, në zbatim të LLP mbështetur në specifikimeve teknike ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet e tenderit përveç kriterëve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese. Disa nga kriteret e veçanta nuk janë përcaktuar në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën kontratës që do të prokurohet, në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik. Sepse janë hartuar teje të fryra dhe kufizuese si dhe nuk stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm. Konkretisht, është kërkuar që operatorët të kualifikohen duhet të paraqesin, 6 apo 7 lloje certificate cilësie, katalogje, fletë analiza malli etj. Këto kriteret janë diskriminuese, sepse e kufizojnë ndjeshëm tregun duke e përqendruar vetëm te prodhuesit apo te operatorët të tregut të shumicës dhe nuk stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm. Mallrat apo materialet që kërkohen të prokurohen janë mallra të zakonshme pastrimi të konsumit të gjerë dhe për furnizimin e tyre nuk kërkohet ndonjë kualifikim apo specialitet të veçantë të operatorëve ekonomik që operojnë në këtë treg, i cili është treg mjaft i mirënjohur. Madje fare mirë furnizimi i këtyre materialeve mundë të bëhet nga operatorët të tregut të pakicës të cilët konkurrojnë ligjërisht dhe rregullojnë tregun e këtyre mallrave si në çmim dhe në cilësi. Parregullsitë dhe shkeljet në hartimin dhe përcaktimin e kërkesave të veçanta kualifikuese janë bërë shkaqe për s`kualifikime të padrejta të operatorëve që kanë konkurruar në këtë procedurë. Konkretisht: Në tender kanë marrë pjesë 5 operatorë. Janë kualifikuar 2 operatorë. Fitues ka dalë operatori “W...” me vlerë oferte 43,411,076.85 lekë. Janë s`kualifikuar 2 operatorët e tjerë të cilët kanë paraqitur oferta më të ultë se operatori fitues, respektivisht: operatori “A.A” me diferencë më pak në vlerën 11,462,661.85 lekë dhe operatori “A.” me diferencë më pak në vlerën 4,811,076 lekë. Këta operatorët, janë s`kualifikuar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 sepse, mangësitë apo paqartësitë e konstatuara në dokumentacionin e ofertave teknike të këtyre operatorëve kanë të bëjnë pikërisht me kërkesat e veçanta të cilat siç u tha më sipër janë hartuar në kundërshtim, me rregullat e prokurimit publik. KVO, nisur edhe nga ofertat më të ulëta në tender, në zbatim të pikës 1 të nenit 53 të këtij ligji, duhej të kërkonte sqarime këtyre ofertuesve për këto mangësi, me qëllim shqyrtimin dhe vlerësimin ofertave të tyre sa më të drejtë në krahasimin me ofertat e tjera. *Mirëpo, i ka qëndruar strikt kërkesave të vendosura nga Njësia e Prokurimit duke mos ju referuar kësaj baze ligjore për ti konsideruar këto mangësi devijime të vogla, sepse i gjithë dokumentacioni i kërkuar për përmbushjen e këtyre kërkesave të veçanta është i panevojshëm dhe nuk ka të bëjë me thelbin e kontratës dhe nuk ndikon dhe nuk pengon ekzekutimin e saj në rast të shpalljes fitues të operatorit që kishte ofertën në vlerë më të ulët. Këto shkelje kanë impakt negativ në buxhetin e shtetit pasi 13,755,194 lekë, fonde buxhetore janë përdorur pa efektivitet dhe pa ekonomikitet. Kjo vlerë është llogaritur si difference e vlerës së ofertës së operatorit fitues me vlerën e ofertës më të ulët të operatorit të s`kualifikuar (trajtuar më hollësisht në faqen 31-34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për sa më sipër rekomandojmë:

- Ministria e Brendshme (Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara) të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësinë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike **në vlerën 13,755,194 lekë**.

Menjëherë

3. Në procedurën e prokurimit “Restaurimi i godinës së Ministrisë së Punëve të Brendshme” me fond limit në vlerën 229,378,112.73 lekë, OQB, mbështetur në projektin e zbatimit, në preventivin e zbatimit dhe në specifikimeve teknike ka hartuar dhe vendosur në DT kriteret të veçanta kualifikuese. Disa nga kriteret e veçanta nuk janë përcaktuar në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që do të prokurohet. Sepse janë hartuar teje të fryra, diskriminuese dhe kufizuese dhe nuk stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm. Të krijohet dhe të japin përshtypje sikur janë vendosur enkas për të favorizuar dhe përzgjedhur operatore të veçantë. Konkretisht:

Në tender janë paraqitur vetëm 2 operatorë. KVO, ka kualifikuar dhe e ka shpallur fitues operatorin “F...” me vlerë oferte 228,235,204.5 lekë, dhe ka s’kualifikuar bashkimi e operatorëve ekonomik “N.S.M” me vlerë oferte 160,859,917 lekë, me diferencë më pak nga fituesi në vlerën 67,375,287.5 lekë, pa TVSH. KVO gjatë vlerësimit të ofertës teknike ka vepruar me dy standarde sepse, nga njëra anë ka s’kualifikuar JV “N.S.M” për mos plotësim të disa kërkesave të veçanta të cilat nuk janë të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe nuk ndikojnë në ekzekutimin me sukses të saj, dhe nga ana tjetër ka kualifikuar operatorin “F..” dhe e ka shpallur fitues i cili edhe ky si operatori i lartpërmendur ka mangësi në dokumentacion për plotësimin e disa kërkesave të veçanta të cilat edhe këto nuk ndikojnë në ekzekutimin me sukses të kontratës. *Këto shkelje kanë impakt negativ në buxhetin e shtetit pasi 80,845,545 lekë, fonde buxhetore janë përdorur pa efektivitet dhe pa ekonomikitet (trajtuar më hollësisht në faqen 34-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Ministria e Brendshme (Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara) të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësinë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve buxhetore **në vlerën 80,845,545 lekë**, në procedurën e prokurimit “Restaurimi i godinës së Ministrisë së Punëve të Brendshme”.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore” dhe nenin 59 “Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 171, datë 26.3.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil”, **i rekomandojmë, Drejtorit të Drejtorisë së Prokurimeve të Përqendruara:**

Të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësisë, shkallën e përgjegjësisë për mangësitë dhe shkeljet për secilin punonjës, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të filloi procedurat për dhënien e masave disiplinore:

Nga “Vërejtje” deri në “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj”, për:

1. Znj. J. Q, Specialiste në DPP:

Kjo punonjëse me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurat e prokurimit, ”Blerje vajra lubrifikant, alkool frenash dhe pastrues motori”, me fond limit 39,055,625 dhe me cilësinë Anëtarit të Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit, në procedurën e prokurimit “Blerje materiale pastrimi” me fond limit 48,269,522 lekë,” të realizuara në vitin 2015, ka vepruar në kundërshtim, me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e Prokurimin Publik.

2. Znj. A. N, Specialiste në DPP:

Kjo punonjëse me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurën e prokurimit, ”Blerje vajra lubrifikant, alkool frenash dhe pastrues motori” me fond limit 39,055,625 dhe “Restaurimi i godinës së Ministrisë së Punëve të Brendshme” me fond limit 229,378,112.73 lekë, të realizuara në vitin 2015, ka vepruar në kundërshtim me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e Prokurimin Publik.

3. Znj. F. L, Specialiste në DPP

Kjo punonjëse me cilësinë e Anëtarit të Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit, në procedurën e prokurimit “Blerje materiale pastrimi” me fond limit 48,269,522 lekë, të realizuar në vitin 2015, ka vepruar në kundërshtim, me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e Prokurimin Publik.

4. Z. E. S, Specialist në DPP:

Ky punonjës me cilësinë e Anëtarit të Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit, në procedurat e prokurimit, “Blerje materiale pastrimi” me fond limit 48,269,522 lekë dhe “Restaurimi i godinës së Ministrisë së Punëve të Brendshme” me fond limit 229,378,112.73 lekë, të realizuara në vitin 2015, ka vepruar në kundërshtim, me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e Prokurimin Publik.

5. Z. Y. P, Specialist në DPP:

Ky punonjëse me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurën e prokurimit, “Blerje materiale pastrimi” me fond limit 48,269,522 lekë dhe me cilësinë e Anëtarit të Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit, në procedurën e prokurimit, “Restaurimi i godinës së Ministrisë së Punëve të Brendshme” me fond limit 229,378,112.73 lekë, të realizuara në vitin 2015, ka vepruar në kundërshtim me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e Prokurimin Publik.

6. Znj. A. H, Specialiste në DPP:

Kjo punonjëse me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurat e prokurimit, “Blerje materiale pastrimi” me fond limit 48,269,522 lekë, të realizuar në vitin 2015, ka vepruar në kundërshtim me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e Prokurimin Publik.

7. Z. F. Z, Specialist në DPP:

Ky punonjës me cilësinë e Anëtarit të Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit, në procedurën e prokurimit, “Restaurimi i godinës së Ministrisë së Punëve të Brendshme” me fond limit 229,378,112.73 lekë, të realizuar në vitin 2015, ka vepruar

në kundërshtim me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e Prokurimit Publik.

8. Z. A. G, Specialist në DPP:

Ky punonjës me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurën e prokurimit, “Restaurimi i godinës së Ministrisë së Punëve të Brendshme” me fond limit 229,378,112.73 lekë, të realizuar në vitin 2015, ka vepruar në kundërshtim me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e Prokurimit Publik.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R